



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:273050
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05722287

C.nr.9174/21

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerand Rrmoku, në çështjen juridike kontestimore ndërmjet paditëses A.S nga P, e përfaqësuar në bazë të autorizimit nga M.P, avokat me seli në P, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - DKA, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga A.SH – zyrtare e lartë ligjore pranë të paditurës, me objekt kontesti pagesën e kontributeve pensionale, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor - publik, me datë 21.05.2024, në prezencën e përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, me datë 22.05.2024, mori dhe në të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI si e bazuar kërkesëpadia e paditëses A.S nga P, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - DKA, me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kontributeve pensionale të pa paguara nga pushimi pa pagesë në vendin e punës me rastin e shoqërimit të bashkëshortit në mision diplomatik për periudhën kohore 01.09.2016 - 31.08.2020, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,185.70 € (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë cent), dhe atë në llogarinë personale të paditëses në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe ta bëjë deklarin pranë Administratës Tatimore të Kosovës dhe Trustit Pensional për periudhën e deklaruar, të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës - DKA, me seli në Prishtinë, që paditëses A.S nga P, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 260.00 € (dyqind e gjashtëdhjetë euro), dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

- Rrjedha e procedurës dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse -

Paditësja A.S nga P, përmes përfaqësueses së autorizuar, av.M.H-J, pranë kësaj Gjykate me dt.06.12.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – DKA, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti pagesën e kontributeve pensionale. Në referatin e padisë ndër tjera pretendohet se paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune pranë të paditurës, në pozitën ... në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “P” në P, për periudhë të pa caktuar. Tutje pretendohet se në bazë të nenit 40 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës, me kërkesën e paditëses nr.03-061-44179, të dt.24.02.2016,

e paditura me dt.10.03.2016 ka lëshuar Vendimin 03 Nr.061-44179 për mungesë nga puna pa pagesë për periudhën kohore nga dt.01.09.2016, deri sa bashkëshorti i saj të jetë në shërbim diplomatik, duke u bazuar edhe në nenin 34 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës. Më tej në referatin e padisë janë cituar dispozitat e lartëcekura nga neni 40 e Ligjit të Punës si dhe neni 34 e Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, duke shtuar se pasi që paditësja është kthyer në punë me dt.01.09.2020, ka kërkuar nga punëdhënësi përmbushjen e obligimit për pagesën e kontributeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, mirëpo kjo kërkesë nuk është realizuar nga punëdhënësi, andaj paditësja i është drejtuar Inspektoratit të Punës, i cili në bazë të vendimit Nr.01/50(L)37/2021, të dt.22.02.2021, e ka obliguar punëdhënësin që në afat prej 8 ditësh të ndërmarrë këto masa: Të bëjë pagesën e tatimeve sipas Ligjit për të Ardhura Personale (Kontributeve), pagesave të pa paguara për periudhën sa ankuesja ka qenë në shoqërim të bashkëshortit në mision diplomatik dhe të bëjë deklarin në ATK dhe në trustin pensional për muajt e pa deklaruar. Kundër këtij vendimi, pretendohet se nuk është ushtruar ankesë, mirëpo pala paditëse ka hasur në pengesa sa i përket vendosjes së vulës së plotfuqishmërisë dhe për këtë ka kërkuar sqarime shtesë nga Inspektorati i Punës dhe Kryeinspektorati i Inspektoratit të Punës, të cilët kanë dhënë sqarime së pse vendimit në fjalë nuk po i vihet vula e plotfuqishmërisë. Më tutje theksohet se me qëllim që procedura të jetë më efikase, padisë i është bashkangjitur edhe Urdhër Obligimi për Pagesë, nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave e Republikës së Kosovës, ku është caktuar shuma për pagesë në vlerë prej 1,185.70 Euro, si dhe periudha e pagesës nga dt.01.09.2016-31.08.2020 dhe shkëmbimet përmes email-adresave ndërmjet paditëses dhe Inspektoratit të Punës. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, ka propozuar që të vendoset si në petitem të kërkesëpadisë.

Përmes parashtresës së deponuar në Gjykatë me dt.05.04.2024, paditësja përmes përfaqësueses së autorizuar e ka bërë zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv, me ç'rast ka propozuar që krahas të paditurës Komuna e Prishtinës - DKA, me seli në Prishtinë, në cilësinë e të paditurës duhet të jetë edhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës. Mbi këtë bazë, Gjykata në kuptim të nenit 264 par.1 dhe 2 të LPK-së, e ka njoftuar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Republikës së Kosovës, duke e ftuar që të deklarohet nëse e jep pëlqimin lidhur me zgjerimin e padisë, me ç'rast përmes parashtresës së dt.16.04.2024, nga subjekti në fjalë është njoftuar se nuk e jep pëlqimin për të hyrë si palë në procedurë. Bazuar në këto rrethana, Gjykata përmes aktvendimit procedural në seancën përgaditore të dt.21.05.2024 e ka refuzuar zgjerimin e padisë në aspektin subjektiv.

Në seancë përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, si dhe fjalë përfundimtare, paditësja, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka theksuar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke shtuar se e paditura, si punëdhënëse e paditëses në kuptim të dispozitave të nenit 40 pika 2 të Ligjit të Punës t'ia paguajë kontributet e detyrueshme paditëses, e drejtë kjo e cila rrjedhë edhe nga neni 34 pika 1 dhe 2 e Ligjit për Shërbimet e Jashtëm Diplomatike të Republikës së Kosovës. Se të paditurës i takon një e drejtë e tillë, pretendohet që është konstatuar edhe nga Inspektorati i Punës në vendimim e dt.22.02.2021. Pretendimin e palës së paditur lidhur me mungesën e legjitimitetit pasiv si dhe mungesën e planifikimit të një linje buxhetore për këtë kategori të punonjësve e ka kundërshtuar, mbi bazën e pretendimit se paditësja është punëtore e të paditurës, ndërsa detyrimet ligjore duhet të zbatohen. Për fund ka pretenduar se nga referati i padisë dhe provat e bashkangjitura konsideron që paditësja e ka bërë të besueshme të drejtën subjektive, duke kërkuar që të detyrohet t'ia paguajë paditëses kontributet në vlerën prej 5% në shumën prej 1,185.70 Euro për periudhën 01.09.2016 – 31.08.2020 në trustin pensional të Kosovës si dhe ta bëjë deklarin në ATK konform

rregullativës ligjore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuar dhe atë: 104.00 Euro në emër të përpilimit të padisë, 21.00 Euro në emër të taksës gjyqësore për padi si dhe 135.00 Euro për prezantim në një seancë, gjithsejt në shumën prej 260.00 Euro.

E paditura si përmes përgjigjes në padi, të deponuar në Gjykatë me dt.30.01.2024, ashtu edhe në seancën përgaditore, respektivisht atë të shqyrtimit kryesor, e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, fillimisht mbi bazën e pretendimit se të paditurës i mungon legjitimiteti real pasiv, pasi që çështje e kompensimeve të tilla realizohet nga ana e thesarit, pra bie nën diskrecionin e Ministrisë së Financave dhe të njejtat nuk mund të realizohen nga e paditura. Më tutje pretendohet se bazuar në legjislacionin në fuqi, e paditura gjatë përgaditjes së buxhetit nuk ka paraparë linjë të veçantë buxhetore për këtë lloj të kompensimit. Mbi bazën e këtyre pretendimeve, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet e procedurës nuk është deklaruar.

- Gjendja faktike e vërtetuar mbi bazën e provave të administruara -

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje juridike, Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.21.05.2024, gjatë procedurës së administrimit të provave, ka administruar provat materiale si në vijim: Vendimi për mungesë nga puna pa pagesë, 03 Nr.061-44179, i dt.10.03.2016, i lëshuar nga Komuna e Prishtinës; Vendimi i Inspektoratit të Punës Nr.01/50(L)/37/2021, i dt.22.02.2021; Deklarata e Inspektorit të Punës e dt.26.10.2021; Shkresa drejtuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës me nr.ref. 01/2021, e dt.04.11.2021; Komunikimet me email të dt.22.11.2021; Urdhër Obligimi per pagesë me nr.0121, i lëshuar nga Komuna e Prishtinës; Urdhëri per Blerje pa nr reference dhe pa datë; Pasqyrat e të dhënave të kontributit të paditëses A.S per periudhën kohore 01.09.2016 - 31.08.2020; Kërkesa per kompletimin dokumentacionit e dt.28.10.2020; Komunikimet përmes emailit të dt.28.06.2021.

Gjykata në mbështetje të dispozitës së nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, me ç'rast ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara, Gjykatës i rezulton se mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti që paditësja është në marrëdhënie të rregullt pune pranë të paditurës, dhe atë e sistemuar në vendin e punës “...” në SHFMU “P” në P.

Përmes vendimit të lëshuar nga Komuna e Prishtinës – Drejtoria e Arsimit, 03 Nr.061-44179, të dt.10.03.2016, paditëses i është lejuar pushimi pa pagesë nga dt.01.09.2016, deri sa bashkëshorti i saj të jetë në shërbim diplomatik. Në arsyetimin e këtij vendimi është theksuar se paditësja është lejuar të shkojë në pushim pa pagesë për arsye të shoqërimit të bashkëshortit B.S, i emëruar në Gradën Diplomatieke: ... në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Podgoricë/Mali i Zi. Një vendim i tillë është mbështetur në nenin 34, pika 1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Me vendimin e Inspektoratit të Punës, Nr.01/50(L)37/2021, është aprovuar ankesa e paraqitur me datë 21.01.2020, e protokolluar nën numrin rendor 200/2020, nga ana e palës ankuese – këtu paditëses A.S, ndërsa është obliguar punëdhënësi – këtu e paditura që në afat prej 8 ditësh të

ndërmarrë këto masa: I. Të bëjë pagesën e tatimeve sipas ligjit për të ardhurat personale (kontributeve), pagës të pa paguar për periudhën sa ankuesja ka qenë në shoqërim të bashkëshortit në Mision Diplomatik, obliguar me dispozitat e nenit 40 të Ligjit të Punës; II. Të bëjë deklarinimin në ATK dhe Trustin Pensional për muajt e pa deklaruar obliguar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës. Tutje në dispozitiv të këtij vendimi, është theksuar se në rast të mos ekzekutimit, ndaj subjektit do të shqiptohet masa e ndëshkimit me gjobë për mos ekzekutim të vendimit, si dhe është obliguar këtu e paditura që në afatin vijues prej 3 ditësh, pas kalimit të afatit kohor prej 8 ditësh të lajmërojë Inspektoratin e Punës për masat e ndërmarra.

Nga deklarata e lëshuar nga Inspektorati i Punës, me dt.26.10.2021, është konstatuar se pas nxjerrjes së vendimit Nr.01/50(L)37/2021, të dt.22.02.2021, Komuna e Prishtinës, pas pranimi të këtij vendimi nuk ka bërë ankesë, andaj vendimi në fjalë ka statusin e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Nga shkresa drejtuar Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës me nr.ref. 01/2021, e dt.04.11.2021, respektivisht komunikimet me email të dt.22.11.2021, vërtetohet fakti se këtu paditësja ka kërkuar sqarime lidhur me faktin e pamundësisë së vendosjes së vulës së plotfuqishmërisë ndaj vendimit të lartëcekur të Inspektoratit të Punës.

Nga Urdhër Obligimi për Pagesë, me numër reference 0121, i lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se të paditurës si organizatë buxhetore i është caktuar shuma për pagesë në vlerën prej 1,185.70 €

Nga pasqyra e të dhënave të kontributit të paditëses A.S per periudhën kohore 01.09.2016 - 31.08.2020, është pasqyruar muaj për muaj shuma të cilën duhet ta paguajë punëdhënësi në emër të kontributit pensional për të punësuarin në vlerë prej 5% të të ardhurave bruto. Nga kjo pasqyrë, rezulton se shuma e përgjithshme e kontributit pensional, të cilët detyrohet të realizojë punëdhënësi – në këtë rast e paditura nga muaji shtator i vitit 2016, deri në muajin gusht të vitit 2020, arrin në shumën e përgjithshme prej 1,185.70 €.

- Baza ligjore -

Në funksion të vlerësimit të bazës ligjore të kërkesëpadisë së paraqitur, duke marrë për bazë natyrën e kontestit, raportin juridik mes palëve ndërgjyqëse, si dhe kohën kur ka lindur ky raport, fillimisht duhet t'i referohemi dispozitave të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.11.2010, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 1, e cila i referohet qëllimit të këtij ligji përcakton që: “Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj”. Në anën tjetër, dispozita nga neni 2, e cila i referohet fushës së zbatimit, përcakton: “Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës”. Dispozita nga neni 7, par.4 e këtij ligji parasheh që: “Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin t’a lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme”. Në anën tjetër, dispozita nga neni 40 e të njejtit ligj, e cila normon çështjen e mungesës nga puna pa pagesë, decidivisht përcakton që: “1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa

kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit”.

Gjykata po ashtu iu referua edhe Ligjit Nr.03/L-122 për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me dt.16.12.2008, ligj ky i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit. Dispozita nga neni 34 e këtij ligji, e cila normon çështjen e trajtimit të familjarëve të personelit të misioneve diplomatike, përcakton që: “1. Bashkëshortit/es, i/e cili/a e shoqëron nëpunësin në misionin diplomatik, i njihet koha e qëndrimit jashtë shtetit për efekt të përvojës në punë dhe të pagesës së kontributeve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. 2. Bashkëshorti/ja, që në kohën e emërimit të përfaqësuesit diplomatik jashtë shtetit ka punuar në një institucion publik, ka të drejtë të kthehet në këtë vend pune pas kthimit të bashkëshortit/es në atdhe. Institucioni publik ku bashkëshorti/ja ka qenë i/e punësuar, ka detyrimin ta rimarrë në të njëjtin pozitë pune ose në një pozitë të barasvlershme...”

- Vlerësimi përfundimtar i Gjykatës -

Në bazë të të gjitha provave të administruara, rezulton që paditësja A.S, ka munguar në vendin e punës pranë të paditurës, respektivisht i është lejuar të shkojë në pushim pa pagesë mbi bazën e shoqërimit të bashkëshortit, z.B.S, i emëruar në Gradën Diplomate: ... në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Podgoricë, Mal të Zi, sipas vendimit nr.ref 024/2016, të dt.29.01.2016.

Në këtë mënyrë, e njejta ka shfrytëzuar të drejtën e përcaktuar me dispozitën nga neni 40 par.1 të Ligjit të Punës. Në anën tjetër, paragrafi 2 i të njejtës dispozitë ka karakter përjashtues, që nënkupton se dispozita në fjalë parasheh që në kohën e mungesës nga puna pa pagesë pushojnë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella nga marrëdhënia e punës, me përjashtim të të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve. Një beneficion i tillë, për më tepër paditëses, në cilësinë e bashkëshortes së një nëpunësi të misionit diplomatik i garantohet edhe me dispozitën e lartëcituar nga neni 34 par.1 të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës.

Gjykata për nevoja të këtij kontesti u referua edhe në Ligjin Nr.04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, respektivisht nenin 6, i cili në paragrafin 1 përcakton që: “Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e Kursimeve ensionale. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësit për punonjësit që kanë krijuar marrëdhënie pune dhe përfundojnë kur punonjësi arrin moshën e pensionit”. Paragrafi 2 i të njejtit nen përcakton që: “Për financimin e kursimeve pensionale: (a) çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me pesë përqind (5%) të rrogave të përgjithshme të të gjithë punonjësve (siç është përcaktuar me këtë ligj); dhe (b) çdo punonjës paguan një shumë që është baras me pesë përqind (5%) të rrogës së tërësishme të tij.”

Mbi këtë bazë, paditësja është legjitimuar që të kërkojë nga pala e paditur përmbushjen e detyrimit në raport me pagesën e kontributeve pensionale të pa paguara brenda periudhës kohore gjatë së cilës e njejta ka munguar në vendin e punës tek e paditura, e që konsiston në periudhën kohore 01.09.2016 – 31.08.2020.

Në raport me vlerësimin e lartësisë së kërkesëpadisë, rrjedhimisht vlerës së përgjithshme të kontributeve të pa paguara për periudhën respektive, Gjykata u bazua në pasqyrën e të dhënave të kontributit të paditëses A.S per periudhën kohore 01.09.2016 - 31.08.2020, në të cilën është pasqyruar muaj për muaj shuma të cilën duhet ta paguajë punëdhënësi në emër të kontributit pensional për të punësuarin në vlerë prej 5 % të të ardhurave bruto. Nga kjo pasqyrë, rezulton se shuma e përgjithshme e kontributit pensional, të cilët detyrohet të realizojë punëdhënësi – në këtë rast e paditura në periudhën kontestuese arrin në shumën e përgjithshme prej 1,185.70 €. Një shumë e tillë korrespondon edhe me Urdhër Obligimin për Pagesë, me numër reference 0121, e lëshuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se të paditurës si organizatë buxhetore i është caktuar shuma për pagesë në vlerën prej 1,185.70 €.

Gjykata mori në konsideratë faktin se në cilësinë e provës materiale është administruar edhe vendimi i Inspektoratit të Punës, Nr.01/50(L)37/2021, i dt.22.02.2021, me të cilin është aprovuar ankesa e paraqitur me datë 21.01.2020, e protokolluar nën numrin rendor 200/2020, nga ana e palës ankuese – këtu paditëses A.S, ndërsa është obliguar punëdhënësi – këtu e paditura që në afat prej 8 ditësh të ndërmarrë këto masa: I. Të bëjë pagesën e tatimeve sipas ligjit për të ardhurat personale (kontributeve), pagës të pa paguar për periudhën sa ankuesja ka qenë në shoqërim të bashkëshortit në Mision Diplomatik, obliguar me dispozitat e nenit 40 të Ligjit të Punës; II. Të bëjë deklarinimin në ATK dhe Trustin Pensional për muajt e pa deklaruar obliguar me dispozitat e nenit 7 paragrafi 4 të Ligjit të Punës. Tutje në dispozitiv të këtij vendimi, është theksuar se në rast të mos ekzekutimit, ndaj subjektit do të shqiptohet masa e ndëshkimit me gjobë për mos ekzekutim të vendimit, si dhe është obliguar këtu e paditura që në afatin vijues prej 3 ditësh, pas kalimit të afatit kohor prej 8 ditësh të lajmërojë Inspektoratin e Punës për masat e ndërmarra.

Mëgjithatë, nga vlerësimi i përmbajtjes së këtij vendimi, Gjykata vëren se në dispozitiv të të njejtit nuk është specifikuar fare periudha kohore, respektivisht shuma e përgjithshme të cilën subjekti punëdhënës është i detyruar ta paguajë në emër të kontributeve pensionale të pa paguara për të punësuarin si pasojë e mungesës nga puna pa pagesë. Për më tepër, në bazë të thënieve të palëve ndërgjyqëse, rezulton që ky vendim nuk i është nënshtruar fare procedurës së përmbartimit. Në këtë drejtim, vendimi i lartëcekur nuk paraqet ndonjë indikacion në drejtim të vërtetimit të faktit se paditësja mund ta ketë realizuar kërkesën e pretenduar në padi përmes instancave jashtëgjyqësore, që rrjedhimisht do të determinonte edhe shqyrtimin e interesit juridik të të njejtës në këtë procedurë.

Gjykata me rastin e vendosjes po ashtu trajtoi me vëmendje pretendimet e parashtruara nga ana e palës së paditur, si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancat e mbajtura në këtë çështje kontestimore.

Pretendimi i parë ka të bëjë me faktin se të paditurës i mungon i mungon legjitimiteti real pasiv, pasi që çështje e kompensimeve të tilla realizohet nga ana e thesarit, pra bie nën diskrecionin e Ministrisë së Financave. Një pretendim të tillë Gjykata e vlerëson të pa themeltë, për faktin se dispozitat e lartëcekura nga neni 40 e Ligjit të Punës, lidhur me nenin 6 të Ligjit për Fondet Pensionale të Kosovës, detyrimin për pagesën e kontributeve pensionale për të punësuarin ia atribuojnë punëdhënësit – që në rastin konkret rezulton të jetë pikërisht e paditura.

Pretendimin lidhur me mungesën e një linje të veçantë buxhetore për kompensimet e tilla, Gjykata po ashtu e vlerëson pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje, për faktin se një rrethanë e tillë nuk

mund të konsiderohet pengesë që paditësja t'i realizojë të drejtat e garantuara që burojnë nga Ligji i Punës, dispozitat e së cilave janë të karakterit obligativ, nënkuptohet mbi bazën e plotësimit të kushteve specifike. Në këtë mënyrë, pretendimet e ngritura nga ana e të paditurës, Gjykata i vlerësoi pa ndikim në krijimin e një bindje tjetër në raport me vendosjen e kësaj çështje.

Bazuar në rrethanat e elaboruara më sipër, Gjykata vendosi decidivisht si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën Komuna e Prishtinës - DKA, me seli në Prishtinë, që paditëses, në emër të kontributeve pensionale të pa paguara nga pushimi pa pagesë në vendin e punës me rastin e shoqërimit të bashkëshortit në mision diplomatik për periudhën kohore 01.09.2016 – 31.08.2020, t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,185.70 € (një mijë e njëqind e tetëdhjetë e pesë euro e shtatëdhjetë cent), dhe atë në llogarinë personale të paditëses në Trustin Pensional të Kosovës, si dhe ta bëjë deklarimin pranë Administratës Tatimore të Kosovës dhe Trustit Pensional për periudhën e deklaruar, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, nga pika II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 452 par.1, 454 par.1 lidhur me nenin 463 par.1 LPK-së, duke e obliguar të paditurën që paditëses t'ia kompensojë shumën e tërësishme të shpenzimeve të nevojshme në vlerë të përgjithshme prej 260.00 Euro, sipas kërkesës së specifikuar, dhe atë: 104.00 Euro në emër të përpilimit të padisë, 21.00 Euro në emër ta taksës për padi dhe 135.00 Euro në emër të përfaqësimit nga avokati në një seancë gjyqësore. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të aprovuara, Gjykata iu referua Tarifës së Odës së Avokatëve (numrit tarifor 6).

Mbi bazën e të lartcekurave, në mbështetje të nenit 160 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

- Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil -

C.nr.9174/21, datë 22.05.2024

Gjyqtari,
Blerand Rrmoku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.